

“Mjedisi Sot”
Nr 2208 E Enjte 04/10/2007

Pergatitur nga Qendra Rajonale e Mjedisit
Rr. Ismail Qemali, Nr. 27, Kati III
Kutia postare 127, Tirane
Tel/Faks (+355 4) 23 29 28
Email: info@albania.rec.org
Web: <http://albania.rec.org>
www.mjedisisot.info

PERMBAJTJA

NGA VENDI

- Rec shqiperi me shume investime per bashkite e qarkut te korces
- Helmet, qarku i beratit nje trekendesh vdekjeje
- Shkoder, ujesjelles-kanalizimet thithin edhe 15.4 milione euro
- Elbasan, zjarr per here te dyte ne gjinar
- Gati 8 djeges te mbetjeve spitalore me rrezikshmeri te larte

NGA BOTA

- Biokarburantet “mund te pershpejtojne ndryshimet klimatike”
- Transporti detar “hyn ne skemen e bashkimit evropian per tregtimin e karbonit”

Njoftime

- Thirrje per Projekte Mjedisore Kombetare dhe Rajonale per Shoqatat e Shoqerise Civile
- Belgrade Environment for Europe Ministerial Conference: Conference documents available
- Takim diskutimi mbi prezantimin e shqiperise ne takimin e ministrave te evropes, beograd
- Ekspozite “Ne favor te hapesires publike”
- SILENCE Training Workshop - Reducing surface transport noise in urban areas

- Seminar "Hapesira publike urbane dhe demokracia"
- Job announcement - Mediterranean Freshwater Policy Officer
- RESILIENCE 2008 - Resilience, Adaptation and Transformation in Turbulent Times

Te gjitha OJF-te mjedisore dhe ato qe kryejne aktivitete per mjedisin, jane te mirepritura te dergojne informacione ose njoftime, ne adresen 'Mjedisi Sot' info@albania.REC.org, ose Kutia Postare 127, Tirane.

Pergatitja e lajmeve ditore eshte mundesuar ne saje te mbeshtetjes nga Agjencia Spanjolle per Bashkepunim Nderkombetar – AECI.

Nga VENDI

REC Shqiperi me shume investime per bashkite e Qarkut te Korces
Qendra Rajonale e Mjedisit, REC Shqiperi

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC), ne kuader te planifikimit mjedisor per bashkite e qarkut te Korces, mbeshtetur financiarisht nga Agjencia Suedeze per Zhvillim dhe Bashkepunim Nderkombetar (SIDA), i ka akorduar se fundmi bashkise Leskovik 80.000 Euro per investime mjedisore.

Ne kete kuader ne qytetin e Leskovikut pritet te ndertohet nje treg bashkekohor per tregtimin e produkteve vendase, permiresimi dhe perfundimi i rrjetit te kanalizimeve te ujrave te zeza per qytetin dhe pajisjen e te gjithe qytetit me mjete teknologjike per pastimin e tij.

Keto investime jane pjese e mbeshtetjes qe REC Shqiperi i ka akorduar dhe bashkive te tjera te qarkut, ku sapo kane perfunduar investimet ne qytetet Maliq, Bilisht dhe Erseke si dhe me heret ne Pogradec dhe Korce. Totali i investimeve per te gjithe bashkite e qarkut ka shkuar ne 500.000 Euro. Nga ky fond ne bashkite respektive jane permiresuar blloqe banimi, ndertuar rrjete kanalizimesh ujra te zeza e te bardha, rruge e banjo publike si dhe jane shtuar qindra m2 siperfaqe te gjelberuara. Ndihma e dhene ne kete Qark eshte ne kuader te nje kontributi me te gjere te mundesuar nga Qeveria Suedeze dhe qe ka vijuar si rezultat i nje procesi pjesemarres ne hartimin e Planeve Lokale te Veprimit ne Mjedis per bashkite e qarkut.

Investimet ne bashkine Leskovik fillojne ne muajin Tetor dhe pritet te mbyllen brenda ketij viti.

Per me shume informacion mbi kete process, mund te kontaktoni me Qendren Rajonale te Mjedisit (REC) Shqiperi, ne rec@albania.rec.org, tel: 04 23 29 28, ose vizitoni <http://albania.rec.org>

HELMET, QARKU I BERATIT NJE TREKENDESH VDEKJEJE
Sulo Gozhina, gazeta Shekulli, fq. 20

Miliona substanca helmi clirohen cdo dite ne ajer nga vendndodhjet e industrive te vdekura qe ndodhen ne qarkun e Beratit, te ndertuar 50 vjet me pare nga rregjimi komunist, ndersa vazhdojne te digjen keto 17 vjet te demokracise, duke u kthyer ne mini-Cernobil, qe sjell cdo dite vdekjen e ngadalte te popullates qe bashkejeton me keto ish-uzina. Jane tonelate te tera substancash kimike helmuese qe clirohen ne qiellin e hapur dhe me pas perfundojne ne mushkerite dhe gjakun e qytetareve, duke kercenuar ne menyre te panderprere jeten e banoreve, te zonave perreth tyre dhe me gjere.

Pas viteve '90 ne territorin ku ka hedhur rrenjet kjo industri, dhjetera qytetare, duke mos e ditur rrezikun per jeten, kane ngritur shtepite dhe banojne prane ketyre zonave e vazhdojne te mbjellin

perime e te ushqejne kafshet, per qumesht dhe mish, pa i ditur pasojat. Sipas qe mbajne ne leter ne Drejtorine Rajonale te Mjedisit, si dhe instancat e pushtetit vendor, jane plot 12 mije ton mbetje kimike qe ndodhen ne ish Kombinatin e Prodhimit te Armeve ne qytetin e Policanit, 25 cisterna te mbushura me qindra meter kub amoniak ne ish Kombinatin Tekstil ne hyrje te qytetit te Beratit dhe mijera ton nafte e sqfure e shperndare ne mbi 30 ha toke, brenda vijes se verdhe, ne qytetin e Kucoves. Keto mbetje teknologjike shperndajne ne menyre te vazhdueshme e sistematike rrezatim radioaktiv, substancat e se ciles vrasin cdo dite jete njerezish, bimesine dhe te gjitha gjallesat e ketij qarku. Sipas mjekeve specialiste, qe kane pranuar te prononcohen per gazeten, mbetjet helmuese vazhdojne te perhapen nepermjet shirave ne ujin e rrjedhshem qe derdhet ne lumin Osum e qe konsumohet nga banoret e vendosur ne te dy anet e bregut te tij. Kjo ndotje teknologjike helmuese ka ardhur menjehere pas shkaterrimit te uzinave ne vitin '97 dhe pjesa me e madhe e ketyre helmeve gjenden ne siperfaqen e tokes dhe ne qiell te hapur, pa asnje pike sigurie per mbrojtjen e banoreve...

Shkoder, ujesjelles-kanalizimet thithin edhe 15.4 milione euro
r.d., gazeta Panorama, fq. 14

Brenda 3 viteve te ardhshme nje shume prej 15,4 milione eurosh do te investohet ne Shkoder ne sistemin e ujesjelles-kanalizimeve.

Shtimi i orarit te furnizimit me uje te pijshem per banoret e qytetit, zgjerimi i rrjetit te kanalizimeve te ujerave te zeza dhe perpunimi i tyre me qellim permiresimin e cilesise se ujit te liqenit te Shkodres do te jene disa nga objektivat kryesore te ketij investimi. Per zbatimin e ketij projekti do te merret ndermarrja e ujesjelles-kanalizimeve, e cila duhet te perfundoje realizimin e tij deri ne vitin 2010. Gjate dites se djeshme, ne Bashkine e Shkodres eshte nenshkruar marreveshja e mirekuptimit per financimin e projektit te mbrojtjes mjedisore te liqenit te Shkodres, si dhe permiresimin e furnizimit me uje te pijshem. Perfaqesuesit e Agjencise se Zhvillimit dhe Bashkepunimit Austriak, te Bankes Gjermane "KFE", Sekretariatit te Shtetit Zviceran per Ceshtjet Ekonomike si dhe Bashkise se Shkodres kane nenshkruar marreveshjen e mirekuptimit, e cila i hap rruge investimeve. Sipas kryebashkiakut Lorenc Luka, ky projekt synon te kontribuojne ne mbrojtjen e burimeve natyrore te ujit ne rajonin e Shkodres dhe ne permiresimin e kushteve te jeteses se popullsisë nepermjet rehabilitimit te furnizimit me uje te pijshem dhe sistemimit te ujerave te zeza. "Nepermjet ketyre investimeve mendohet te arrihet mbulimi i kostos te sistemeve te ujit te pijshem dhe te ujerave te zeza, (duke futur ne to sherbimet dhe mirembajtjen) si dhe nje organizim efikas te kesaj ndermarrjeje", theksoi Luka. Gjithashtu eshte mesuar se krahas rritjes se furnizimit me uje te pijshem, uljes se humbjeve ne rrjet eshte parashikuar qe te behet i mundur zgjerimi i sistemit te kanalizimeve dhe ndertimi ne nje faze te mevonshme te nje impianti te perpunimit te ujerave te zeza, te cilat do te shoqerohen me permiresimin perfundimisht te cilesise se ujit te liqenit te Shkodres.

ELBASAN, ZJARR PER HERE TE DYTE NE GJINAR
Gazeta Panorama, fq. 14

Nje zjarr i fuqishem ne piken turistike te Gjinarit e rrezikon ate per here te dyte brenda pak javesh. Flaket perfshine rreth 10 hektare siperfaqe, duke e kthyer situaten ne alarmante. Makinat zjarrfikese nuk kane mundur te arrijne per shkak se zjarri ndodhet ne nje zone malore. Nderkohe qe prefekti i Qarkut te Elbasanit, Rezart Kovaci, sapo eshte njohur me situaten ka marre kontakte me kreun e komunes, forcat e ushtrise dhe ato te sherbimit pyjor. Vetem nderhyrja e tyre ka ndihmuar ne lokalizimin e flakeve qe rrezikonin te shkaterronin nje siperfaqe te madhe me pyje ne zonen turistike.

GATI 8 DJEGES TE MBETJEVE SPITLORE ME RREZIKSHMERI TE LARTE

Gazeta Ballkan, fq. 6

Ministria e Shendetesise, ne kuader te projektit dhe programit qe ka me Banken Boterore, ka parashikuar dhe eshte ne proces sigurimi i 8 incineratoreve ose ndryshe, te djegesve te mbetjeve spitalore. Sipas burimeve ne Ministrine e Shendetesise, dy prej djegesve spitalore do te vendosen ne Tirane, perkatesisht njeri midis dy instituteve , atij te Shendetit Publik dhe te Kerkimeve Veterinare dhe tjetri ne Qendren Spitalore Universitare "Nene Tereza". Incineratori i pare do te sherbeje per djegine e te gjitha mbeturinave qe do te prodhojne dy institutet, mbeturina qe klasifikohen sipas specialisteve te mjedisit dhe te shendetesise, me rrezikshmeri te larte, ndersa pjesa tjetere e numrit do te vendosen ne qendrat spitalore rajonale te vendit. Realizimi i blerjes se ketyre incineratoreve ka kaluar ne disa faza, sic jane faza e percaktimit te termave te references dhe e specifikimit teknik te aparaturave te reja. Te gjitha parametrat qe tani jane vendosur, jane ripare dhe nga eksperte te huaj dhe i perkasin teknologjise se fundit boterore. Arsyeya per te cilen behet nje levizje e tille, eshte mbrojtja e mikro dhe makro mjedisit prane spitaleve nga perhapja e gazrave kancerogjene, si dioksina dhe furrana qe leshohen aktualisht nga incineratoret e vendosur neper qendra spitalore.

NGA BOTA

BIOKARBURANTET "MUND TE PERSHPEJTOJNE NDRYSHIMET KLIMATIKE"

Nje rritje masive e prodhimit dhe perdorimit te biokarburanteve mund te nxise shpyllezimet dhe humbjen e biodiversitetit, duke ndikuar ne pershpejtimin e ndryshimeve klimatike, ben te ditur instituti amerikan Worldwatch.

"Sa me te medha dhe me te industrializuara te behen industrite e biokarburanteve, aq me shume perpjekje politike do te duhen per te plotesuar qellimet sociale dhe mjedisore", shprehet instituti ne nje liber te ri te titulluar "Biokarburantet per transport". Qeverite duhet te nxisin prodhimin e biokarburanteve ne nivel te madh dhe te vogel, argumentojne autoret e librit. Kjo kerkon zhvillimin e politikave dhe teknologjive te vecanta.

Nder rekomandimet e tjera, autoret e librit shprehin se zhvillimi i certifikimit te qendrueshem kombetar dhe nderkombetar eshte thelbesor ne mbrojtjen e sistemit dhe ruajtjen e besimit te publikut te biokarburantet. Ata, gjithashtu, theksojne se biokarburantet nuk do te zgjidhin perfundimisht sfidat e botes per energjine e transportit, dhe per kete duhet te zhvillohen alternativa te tjera "brenda kontekstit te kalimit drejt nje sektori te transportit global me efikas, me pak ndotes dhe me i diversifikuar".

Per me shume informacion:

<http://www.worldwatch.org/>

Transporti detar "hyn ne skemen e Bashkimit Evropian per tregtimin e karbonit"

Sektori i transportit detar do te perfshihet ne skemen e Bashkimit Evropian per tregtimin e karbonit, konfirmon Komisioni Evropian. Komisioni pritet te ndermarre masa konkrete pasi u pa qe perpjekjet per reduktimin e shkarkimeve ne nivel global nepermjet Organizates Nderkombetare

Detare nuk po sjellin perfitimet e duhura ne kohe te shpejte. Ne vjeshte do te fillojne bisedimet mbi propozimet e mundshme ligjore per te ndryshuar skemen.

“Mund te themi qe Bashkimi Evropian po ecen perpara i vetem, pasi OND-ja nuk arriti progresin e duhur qe shpresohet”, shprehet nje zyrtar i BE-se. “Eshte pak a shume e ngjashme me skemen per aviacionin”, vazhdon me tej zyrtari. Bashkimi Evropian po pergatit legjislacionin per te perfshire dhe transportin ajror ne skemen e tregtimit te shkarkimeve brenda disa viteve. Shkarkimet nga te dy sektoret jane harruar nga objektivat e Protokollit te Kiotos per reduktimet ne toke saqe dhe masat jane bere publike nepermjet Organizates Nderkombetare Detare dhe homologut te saj te aviacionit ICAO.

Industria e anijeve mund te refuzoje planet e Bashkimit Evropian. Bill Box i shoqates se pronareve te anijeve cisterne “Intertanko” shprehet se aplikimi i skemes se tregtimit te shkarkimeve per anijet do te godase me shume anijet qe qarkullojne zakonisht si ne ujerat e Bashkimit Evropian dhe ato jo evropiane. “Kur Evropa fillon te bisedoje per ceshtje qe dalin jashte sistemit nderkombetar, ne fillojme te shqetesohemi. Transporti detar ka nevojte per rregulla nderkombetare, vecanerisht kur behet fjale per shkarkimet dhe karburantet”, shprehet Box.

Grupi per Transportin dhe Mjedisin shprehet se Komisioni duhet te vendose dhe tarife portuale, per distancen dhe takse per karburantet ne transportin detar.

Per me shume informacion:

http://ec.europa.eu/index_en.htm

Njoftime

Thirrje per Projekte Mjedisore Kombetare dhe Rajonale per Shoqatat e Shoqerise Civile

Qendra Rajonale e Mjedisit per Europen Qendrore e Lindore (REC), me mbeshtetjen e Agjencise Suedeze per Zhvillim dhe Bashkepunim Nderkombetar (Sida), hap raundin e pare te pranimit te propozimeve nga Organizata te Shoqerise Civile per projekte qe lidhen me mjedisin urban dhe qendrueshmerine ne rajonin e Ballkanit Perendimor.

Ky program grantesh do te identifikojte dhe mbeshtese projekte kombetare, te Organizatave te Shoqerise Civile, per nxitjen qendrueshmerise urbane ne Shqiperi dhe ne pese vendet e tjera te rajonit. Qellimi kryesor i ketij programi grantesh eshte aftesimi i aktoreve te shoqerise civile per te trajtuar ceshtje te mjedisit urban dhe te zhvillimit te qendrueshem ne Shqiperi. Njekohesisht, mbeshtetja duhet te rezultojte ne forcimin e shoqerise civile per te:

- rritur ndergjegjesimin e komunitetit lidhur me kushtet dhe zgjidhjet e mundshme te problemeve ne sektorin e mjedisit (vecanerisht per problemet mjedisore qe lidhen me shendetin); dhe
- nxitur ndryshimet pozitive mjedisore, nepermjet lobimit, advokacise dhe monitorimit te qeverisjes dhe biznesit.

Gjithashtu, programi i granteve do te synojte te nxise parime te rendesishme demokratike, te lidhura me te drejtat dhe zbatimin e tyre nga organizatat qe do te marrin pjese ne program. Barazia gjinore dhe aspekte etnike do te merren parasysh, se bashku me ceshtjet e zakonshme mjedisore gjate vleresimit te propozimeve. Kjo do te thote zbatim te ketyre parimeve permes realizimit te projektit, ndarje e drejte e fondeve, si dhe mbeshtetje e drejtperdrejte e aktiviteteve nderetnike.

Programi parashikon dy skema grantesh, ne nivel kombetar dhe rajonal.

Shuma totale e fondeve per kete Thirrje te pare eshte 71.270 EUR. Shuma per secilin grant eshte ndermjet 8000 deri ne 10.000 EUR, ne raste shume te vecanta nje grant mund te arrije deri ne 15.000 EUR (shiko Thirrjen e plote per kerkesa me specifike). Projekt ideja, ne origjinal, duhet te dorezohen ne zyren e REC ne Shqiperi brenda dates 16 nentor 2007.

Procesi i perzgjedhjes do te zhvillohet gjate periudhes Nentor 2007 – Maj 2008. propozimet do te vleresohen nga Bordi Keshillimor i REC. Propozimet me te mira do te perzgjidhen ne muajin shkurt 2008, kundrejt kritereve te vleresimit, te publikuara ne Thirrjen per Projekt Ide. Rezultatet e vleresimit do te paraqiten, ne muajin prill 2008 tek Sida per vendimin perfundimtar. Zbatimi i projekteve do te zgjase jo me shume se 12 muaj, ne periudhen qershor 2008 – maj 2009.

Thirrja e plote per projekt ide dhe formati i aplikimit gjenden ne zyren e REC ne Shqiperi, ose ne adresen e meposhtme ne internet <http://albania.rec.org/Projects/SECTOR/sector.html>

Pervec granteve kombetare, REC do te njoftoje se shpejti dhe raundin e dyte te granteve rajonale. Njoftimi, ne anglisht, i Granteve Rajonale mund te gjendet prane zyres se REC ne Shqiperi, si dhe ne adresen e internetit te projektit: <http://www.rec.org/sector/support/index.html>

Per me shume informacion lidhur me grantet kombetare dhe ato rajonale mund te kontaktoni: ne zyren e REC ne Shqiperi me

Alken Myftiu, e-mail (grants@albania.rec.org); tel/faks: +355 4 232928;

REC Shqiperi

Rr. Ismail Qemali, Nr. 27

Kutia postare 127, Tirana, Shqiperi

Web: <http://albania.rec.org>

Ne Zyrat qendrore te REC ne Hungari me:

Entela Pinguli (e-mail: EPinguli@rec.org; tel: [36-26] 504-000; faks: [36-26] 311-294).

Adresa: Ady Endre ut 9-11, 2000 Szentendre, Hungari

Web: www.rec.org

Belgrade Environment for Europe Ministerial Conference: conference documents available October 10-12, 2007

Next week, from October 10-12, European Environment Ministers will meet in Belgrade, Serbia for the sixth "Environment for Europe" Ministerial Conference.

The Belgrade Environment for Europe Ministerial Conference will bring together some 2000 participants, including ministers and high-level delegates from 56 UNECE member states and the European Commission, representatives of the United Nations organizations, other intergovernmental organizations, non-governmental organizations, financial institutions and the private sector.

One week ahead of the Conference, most of the official conference documents are now available: There will be 28 so called category I documents (i.e., documents for possible action by Ministers), totaling more than 600 pages (!) of text.

In addition there will be 32 category II documents (i.e., background documents of direct relevance to the Conference), totaling more than 2000 pages of text.

All official documents are now available (free of charge) on our website www.environmentforeurope.

[org](#), a new information resource service on the Environment for Europe process made possible with the support of the Swiss Federal Office for the Environment (FOEN). You can browse the list of official documents on our Conference Documents page, our Conference Agenda page, or, in case you are interested in certain/selected themes or work areas only, we recommend that you visit our thematic pages:

- Biodiversity and sustainable development in mountain areas
- Sustainable consumption and production
- State of the European Environment
- Water and wastewater infrastructure
- Education for sustainable development
- Environment and security
- Environmental finance
- Energy and environment
- Multilateral environmental agreements
- Environmental policies, enforcement & compliance

In addition you might be interested to read the draft Belgrade Ministerial Declaration or view the "Future of the Environment for Europe process" discussion paper.

TAKIM DISKUTIMI MBI PREZANTIMIN E SHQIPERISE NE TAKIMIN E MINISTRAVE TE EVROPES, BEOGRAD

Ne Mbledhjen e Ministrave te Mjedisit te vendeve te Europes (54 shtete) qe mbahet ne Beograd nga data 10-12 Tetor, pervec delegacionit zyrtar te Shqiperise, do te kete ne kete takim edhe pjesemarres te shoqerise civile. Ne kete takim do te paraqiten dokumente te rendesishem si nga delegacioni zyrtar dhe nga forume nderkombetare te shoqerise civile ku organizata ambjentaliste nga Shqiperia kane gene presente.

Ne menyre qe te synohet nje qendrim sa me i afert i te gjithe aktoreve te perfshire ne kete proces dhe per te garantuar nje prezantim dinjitoz te vendit ne kete takim paneuropean, Shoqata e Bujqesise Organike, ne bashkepunim me Milieukontakt Oost Europa organizon nje tryeze te rrumbullaket me drejtues te disa shoqatave mjedisore aktive ne kete proces dhe perfaqesues nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerrave dhe Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit.

Tema: Te shkojme ne Takimin e Ministrave te Europes ne Beograd me profil te qarte kombetar:

Koha e takimit: date 5 Tetor ora 9:00 - 11:00

Vendi i takimit: Salla e mbledhjeve ne zyrrat e Shoqates se Bujqesise Organike

Agenda e takimit:

- Prezantim i shkurter lidhur me takimin e Beogradit, menyren e perfaqesimit ne te dhe rendesine e tij
- Paraqitja e platformes se delegacionit shqiptar perfaqesuar nga ministri i Mjedisit;
- Paraqitja e deklarates se OJFve europiane bere ne takimin e Brukselit, 1 mars 2007;
- Paraqitja e deklarates se rrjetit te naftesjellesve te Europes Juglindore 28-30 Shtator 2007, Sisak, Kroaci;
- Percaktimi i pikave te perbashketa te delegacionit qeveritar dhe perfaqesuesve te OJFve;

- Percaktimi i qendrimet te OJFve shqiptare ne Beograd, sidomos lidhur me dy tema kryesore te dites: veprat e naftes ne Vlore dhe fabrikat e cimentos ne Kruje;
- Miratimi i nje deklarate per shtyp te pjesemarrsesve.

Lutemi konfirmoni pjesemarrjen:
Lavdosh Ferruni: 0692099047

EKSPOZITE “NE FAVOR TE HAPESIRES PUBLIKE”

Cmimi europian i Hapesires Publike Urbane 2008

5 tetor - 25 nentor 2007, Galeria e Fakultetit te Arteve Vizive, Akademia e Arteve

Ekspozita e Qendres se Kultures Bashkekohore te Barcelones eshte nje reflektim mbi qytetin dhe hapesiren publike, qe percakton jeten kolektive ne qytete dhe, gjithashtu, perdorimin dhe marredheniet shoqerore qe ato permbajne.

Ne ekspoziten qe do te organizohet nga datat 15 tetor deri ne 25 nentor 2007, ne mjediset e Galerise se Fakultetit te Arteve Vizive, do te paraqiten punimet pjesemarrrese ne Cmimin Europian te Hapesires Publike Urbane. Kjo ekspozite pritet te jete nje kontribut mbi reflektimin per hapesiren publike ne nje Shqiperi ne transformim.

SILENCE Training Workshop - REDUCING SURFACE TRANSPORT NOISE IN URBAN AREAS Warsaw, 14 November 2007

Although noise limits have become increasingly stringent over the years, no corresponding reduction in noise levels in urban areas has been observed. Therefore, European noise policy has been revised to focus on noise perception, to avoid the harmful effects of noise exposure from all sources, and to preserve quiet areas. This is reflected in the European Directive on Environmental Noise that Member States have to comply with.

SILENCE, a research project co-funded by the European Commission, develops an integrated methodology for the improved control of surface transport noise in urban areas. SILENCE provides relevant and world-leading technologies for the efficient control of surface transport noise, innovative strategies for action plans on urban transport noise abatement, and practical tools for their implementation. Now that the project is in its final phase, many results become available.

This Training Workshop aims to inform interested stakeholders (national, regional and local authorities, transport and urban planners, research institutes, consultants...) on these outcomes of SILENCE, will point out the potential of different noise abatement measures and will help national, regional and local authorities to comply with European legislation.

Participation is free of charge.

Interpretation English – Polish will be provided.

Registration deadline: 22.10.2007

The workshop will take place at:

CPS “DIALOG” Limanowskiego 23 Str., Warsaw,

phone +48 22 842 0561, +48 22 651 5935;

fax +48 22 842 1335

e-mail: sekretariat@cpsdialog.pl;

website: www.cpsdialog.pl

For more information:

www.silence-ip.org

SEMINAR "HAPESIRA PUBLIKE URBANE DHE DEMOKRACIA"

15 tetor, ora 09.00, Hotel Sheraton, Tirane

Ne daten 15 tetor 2007, ne mjediset e hotel Sheraton do te zhvillohet nje takim nderkombetar ndermjet urbanisteve, personaliteteve te shquara te botes se kultures, politikes dhe mjeteve te komunikimit, te cilet do te debatojne rreth konceptit te Hapesires Publike, aplikimeve praktike dhe reperkusioneve sociale te saj. Ky takim eshte nje bashkepunim midis Qendres se Kultures Bashkekohore te Barcelones, Institutit per Dialog dhe Komunikim dhe Institutit Shqiptar te Medias, me synim zhvillimin e nje debati mbi keto ceshtje ne Shqiperi.

Job announcement - Mediterranean Freshwater Policy Officer

WWF, the global conservation organisation, is seeking a Mediterranean Freshwater Policy Officer to be based in the Mediterranean Programme Office in Rome.

The position will support WWF in identifying key policy processes impacting on water ecosystems in the Mediterranean region and planning policy and advocacy actions with the aim of creating a policy context that supports freshwater ecosystem conservation and sustainable management both at the EU level and across the region. A main focus will be given to the European Neighbourhood Policy and to dam investors. The position will also support the general work of the head of freshwater unit. The job will require extensive networking internal to WWF as well as with a variety of external stakeholders. Extensive travel in the Mediterranean region and to Brussels will be required.

Please do not send an application if the minimum requirements below are not met or if you have already applied for the position. The minimum qualification requirements include:

- Proven work experience on a relevant issue/s in North African and/or Western Balkan countries for a minimum of 3 years;
- A proven experience in policy and advocacy development, with emphasis in the environmental dimension of Mediterranean policies;
- University degree in Political Sciences or in Biological or Ecological sciences with a clear interests in Policy & Advocacy;
- A good understanding of north/south relations in the Mediterranean, specifically with regards to the EU Institutions and their decision-making processes on environment, development and external relations policies and associated funding instruments;
- Good knowledge of the EU institutional set up and mechanisms;
- Experience in project/programme design and management;
- Basic knowledge of key freshwater conservations issues in the Mediterranean;
- Knowledge of WWF network an advantage;
- Fluency in spoken and written English and French, additional knowledge of Arabic an advantage;
- Knowledge of the EU Water Framework Directive an advantage;
- European Union citizenship or Italian permit of stay already obtained due to restrictive

Italian immigration legislation.

This will be initially a one year contract with potential for extension for further two years. Candidates should submit a letter of application with a general justification of the minimum requirements above and a detailed CV in English by email to fw@wwfmedpo.org.

Closing date for applications is 21 October 2007.

Only short-listed candidates will be informed and invited afterwards for an interview.

RESILIENCE 2008 - Resilience, Adaptation and Transformation in Turbulent Times
International Science and Policy Conference, Stockholm, Sweden, April 14-17 2008.

Background information:

Resilience 2008 aims to be more than a regular science conference. On the agenda in Stockholm are plenary sessions, core and short paper sessions, panel and working group sessions, poster sessions, but also open space and futures sessions, a policy forum, a resilience inspired art exhibition and musical performances.

Who is the conference for?

The conference will bring together scientists who work on the complex dynamics of social-ecological systems, to present, discuss, and summarise the current understanding of resilience, adaptability and pathways of transformation in systems of humans and nature. Representatives from government, business and other major actors will be invited to the policy forum to discuss the challenges facing societal development, and together with scientists propose directions to go and pathways to avoid. To explore this further there will be an art exhibition on resilience issues in cooperation with the Royal Swedish Academy of Fine Arts.

Organizers:

Resilience 2008 is organized by the Resilience Alliance in collaboration with the Royal Swedish Academy of Sciences and International Council for Science (ICSU). Local organizers: Stockholm Resilience Centre at Stockholm University, Stockholm Environment Institute (SEI) and Beijer International Institute of Ecological Economics (Conference secretariat).

The themes of the conference:

The overall framework of the Resilience 2008 conference stresses the following features:

- Society and nature represent truly interdependent social-ecological systems
- Social-ecological systems are complex adaptive systems and
- Cross scale and dynamic interactions represent new challenges for governance and management in relation to interdependent social-ecological systems and ecosystem services.

The following overall themes have been proposed to help shed light on the issues, with a few tentative sub-themes to be expanded and further developed during fall 2007.

Abstract submission:

Submission of abstracts for oral and poster presentations will be open from August 15 to November 16. Abstracts must be submitted in English with a maximum word count of 500. Authors will be notified about the outcome of the review process late December 2007.

Further information about the submission will be provided on the conference website www.resilience2008.org

Registration:

Will be open from September 15

Contact:

Christina Leijonhufvud

Mail: chris@beijer.kva.se

www.resilience2008.org

C'eshte "Mjedisi Sot"

"Mjedisi Sot" eshte nje nga botimet periodike te Qendres Rajonale te Mjedisit - Zyra ne Shqiperi. Ne kete botim ditor do te gjeni lajme dhe probleme mjedisore nga shtypi i dites, informacion per aktivitetet mjedisore nga vendi dhe bota.

Per t'u futur falas ne listen e shperndarjes se "Mjedisi Sot" ose per t'u cregjistruar, dergoni nje e-mail ne adresen: info@albania.REC.org

Versionin e shtypur mujor te "Mjedisi Sot" mund ta gjeni prane Zyres se REC ne Shqiperi.

Lajmet mjedisore ditore dhe "Mjedisi Sot" mujor mund t'i gjeni edhe ne internet: <http://albania.REC.org>

www.mjedisisot.info

www.mjedisisot.info

C'eshte REC

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) per Evropen Qendrore e Lindore eshte nje organizate nderkombetare jopartizane, joavokate, jofitimpruese qe mbeshtet zgjidhjen e problemeve mjedisore ne Evropen Qendrore e Lindore (EQL), duke nxitur bashkepunimin ndermjet organizatave joqeveritare, qeverive, bizneseve e aktoreve te tjere mjedisore, si dhe duke mbeshtetur shkembimin e lire te informacionit dhe pjesemarrjen e publikut ne vendimmarrjen mjedisore.

REC eshte krijuar ne 1990 nga ShBA, Komisioni Evropian dhe Hungaria. Sot REC, bazohet ligjerisht ne Karten e tij, nenshkruar nga 28 vende dhe Komisioni Evropian, dhe ne nje marreveshje nderkombetare me qeverine hungareze. REC ka zyren qendrore ne Szentendre, Hungari dhe zyrat e vendeve ne secilin prej 16 vendeve perfituese. Shqiperia e ka nenshkruar Karten e REC ne 1992. Zyra e REC per Shqiperine eshte hapur ne 1994. Kjo zyre punon per realizimin e misionit te REC duke mbeshtetur organizatat jofitimpruese, institucionet mjedisore ne te gjitha nivelet, dhe aktore te tjere te interesuar ne fushen e mjedisit, duke mbeshtetur proceset pjesemarrrese dhe shkembimin e lire te informacionit. Fushat kryesore te veprimtarise jane: Programi i granteve per OJF-te; Planet Lokale te Veprimit ne Mjedis, Informacioni Mjedisor; Edukimi Mjedisor; Programi i kualifikimit per OJF-te dhe zyrtare te mjedisit, nismat dhe programet vendore e rajonale; etj.

Nese jeni te interesuar te njiheni me cfare ndodh cdo dite ne mjedisin

shqiptar dhe neper bote, abonohuni falas ne "Mjedisi Sot", pakete e perditshme elektronike.

Dergoni nje mesazh me titull "Abonim" tek info@albania.rec.org
